



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

Nr. 9645/1 Prot.

Tiranë, më 10/7/2024

Lënda: Dërgohet udhëzimi plotësues i PBA 2025-2027

Ministrisë _____

Institucionit Qendror _____ ✓

Bashkëngjitur gjeni udhëzimin plotësues nr.9 datë 10.7.2024 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027".

Me respekt,

MINISTËR
Ervin Mete



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR

UDHËZIM PLOTËSUES

9645

10. 7. 2024

Nr. 9 Datë 10.7.2024

“PËR
PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027”

Në përputhje me Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 27 dhe nënçështjen 3.2, pika 1 e Udhëzimit nr.7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Ministri përgjegjës për financat;

UDHËZON:

1. Njësiti e Qeverisjes Qendrore të përgatisin dokumentin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027. Ky dokument të punohet mbështetur në tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.
2. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e PBA 2025-2027, në nivel programi, do të dërgohen zyrtarisht në një moment të dytë.
3. Objektivi i fazës teknike të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 është përpunimi i detajeve teknike të buxhetit brenda tavanëve përfundimtare të miratuara. Në këtë kuptim, Njësiti e Qeverisjes Qendrore nuk mund të ri-sjellin kërkesa për financimin e politikave të reja dhe kërkesa për mangësitë në financim të politikave ekzistuese.
4. Të gjitha njësiti e Qeverisjes Qendrore, do të përgatisin kërkesa buxhetore për PBA 2025-2027 përmes sistemit AFMIS, dhe moduleve respektive të përgatitjes së PBA dhe PIM. Raportet e kërkesave buxhetore të gjeneruara përmes sistemit AFMIS do të dorëzohen zyrtarisht në Ministrinë përgjegjëse për financat.
5. Versioni i punës në sistemin AFMIS që do të zgjidhet nga ana juaj, për fazën teknike duhet të jetë ai i tavanëve të pandryshueshme.
6. Përjashtëimisht grupi 63 dhe grupi 87, duhet të përgatisin kërkesat buxhetore për PBA 2025-2027 sipas formateve excel dhe së bashku me relacionin shpjegues t'i përcjellin zyrtarisht brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim, në hard copy në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe elektronikisht në adresën: budget.programming@financa.gov.al.

7. Krahas kërkesave buxhetore të përgatitura me sistemin AFMIS, njësitë e qeverisjes së qendrore, për fazën teknike do të paraqesin informacion në kuadër të përgatitjes së projektbuxhetit vjetor sipas formateve standarde bashkëlidhur këtij udhëzimi në shtojcën nr.1/A, të cilat përmbajnë:

- Pasqyra nr.1 “Të ardhurat e Veta”
- Pasqyra nr.2 “Buxheti Vjetor 2025”
- Pasqyra nr.2/1 “Buxheti Vjetor 2026”
- Pasqyra nr.2/2 “Buxheti Vjetor 2027”
- Pasqyra nr.2/3 “Pagesat e parashikuara për PPP”
- Pasqyra nr.3 “Përmbledhësja e Pagave”
- Pasqyra nr.4 “Numri i punonjësve”
- Pasqyra nr.5 “Fluksi i parasë”
- Pasqyra nr.6 “Investimet Publike me financim të brendshëm”
- Pasqyra nr.7 “Investimet Publike me financim të huaj”

8. Kurset e Këmbimit për vitet 2018-2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2027, që do të përdoren në planifikimin e shpenzimeve për projektet me financim të huaj, jepen si më poshtë:

Nr	Monedhat	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027
1	Kurs i këmbimit mesatar Lek/USD	108.0	109.9	108.6	103.5	113.0	100.6	100.6	100.6	100.6	100.6
2	Kurs i këmbimit mesatar Lek/EURO	127.6	123.0	123.8	122.5	119.0	108.8	108.8	108.8	108.8	108.8

9. Buxhetimi gjinor dhe gjithëpërfshirës në përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027

a) Në zbatim të ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të udhëzimit të përbashkët nr.21, datë 21.06.2013 “Për përcaktimin e procedurave për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore qendrore, duhet të kryejnë analiza me bazë gjinore të sektorit përkatës, me qëllim:

- a. përcaktimin e objektivave dhe treguesve të performancës me bazë gjinore, që ndihmojnë në kryerjen e analizave gjinore të sektorit përkatës dhe matjen e performancës së programit buxhetor.
- b. detajimin e objektivave me bazë gjinore në produkte dhe kosto, të cilat synojnë zbutjen e pabarazive gjinore apo/dhe arritjen e barazisë gjinore, aty ku është e mundur.

Treguesit kyç të performancës me bazë gjinore dhe statistikat e nevojshme për përcaktimin e tyre, mund të konsultohen në link-un: <https://financa.gov.al/buxhetimi-gjinor-2/>.

Për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor nisur nga sa më sipër, Ministria përgjegjëse për financat, me asistencën e UN Women në Shqipëri, do të mbështesë EMP e programeve në procesin e draftimit të

objektivave, treguesve kyc të performancës me bazë gjinore, produkteve dhe kostove që ndikojnë në avancimin e politikave të barazisë gjinore.

- b) të gjitha institucionet përgjegjëse të planifikojnë masa konkrete buxhetore zbutëse dhe përshtatëse për ndryshimet klimatike, në përputhje me planin kombëtar për energjinë dhe klimën, të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohet një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre.

10. Afatet për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027

- a) Datat kryesore të Kalendarit të Menaxhimit të Shpenzimeve Publike për vitin 2024, të detyrueshme për t'u zbatuar për qëllim të këtij Udhëzimi, janë:
- Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për **Fazën strategjike**, në të cilën përfshihen edhe propozimet për investimet publike, është **deri më datë 1 Maj 2024**;
 - Udhëzimi Plotësues i Përgatitjes së Buxhetit, duhet të shpërndahet tek Njësitë e Qeverisjes Qendrore pas miratimit të draftit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 nga Këshilli i Ministrave, brenda datës **10 Korrik 2024**;
 - Afati për dorëzimin e Kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 për **Fazën teknike**, është **deri më datë 2 shtator 2024**;
 - Datat e seancave dëgjimore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027, për **Fazën strategjike**, paraqiten në **Tabelën nr.2**, bashkëlidhur këtij Udhëzimi. Në periudhat **20 Maj – 29 Maj 2024**, dhe **16 Shtator-24 Shtator 2024**, Ministria përgjegjëse për financat do të zhvillojë seancat dëgjimore me të gjithë anëtarët e Grupeve të Menaxhimit Strategjik të Njësive të Qeverisjes Qendrore. Në këto seanca do të marrin pjesë gjithashtu, përfaqësues nga struktura përgjegjëse për planifikimin strategjik në Kryeministri dhe në Agjensinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Kordinimit të Ndihmës, struktura përgjegjëse për integrimin europian në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe një përfaqësues për çështjet gjinore nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në rolin këshillimor, gjatë të cilave do të diskutohen kërkesat për Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 të dërguara prej tyre. Në këto seanca do të jepen konkluzionet dhe rekomandimet përkatëse, sipas fushave përkatëse nga përfaqësuesit e institucioneve të sipërcituara, të cilat do të përfshihen në raportin përmbledhës të përgatitur nga Ministria përgjegjëse për financat, raport i cili u dërgohet zyrtarisht Njësive të Qeverisjes Qendrore.
- b) Ndëshkimet e parashikuara në nenin 71, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, do të zbatohen për nëpunësit autorizues në çdo rast të mundshëm të mosrespektimit të këtij udhëzimi.

11. Ndjekja e Procesit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Mbështetja Këshillimore

- Ndjekja dhe zbatimi me përpikmëri e këtij Udhëzimi nga ana e Njësive të Qeverisjes Qendrore do të raportohet rregullisht nga ministri përgjegjës për financat në Këshillin e Ministrave.

- Të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore, krahas dorëzimit të kërkesave buxhetore në hard copy në Ministrinë përgjegjëse për financat brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim, duhet t'i dërgojnë elektronikisht këto kërkesa dhe në adresën e e-mail: budget.programming@financa.gov.al.

